# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6881
E enjte, 27 prill 2023
Çmimi 0.40


## KQZ-ja shpall rezultatet e zgjedhjeve në veri

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË PLENARE FAQE 4-5

# ‘PËRPLASJE’ NË MES TË POZITËS DHE OPOZITËS PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË KEK



Me kërkesë të deputetëve opozitarë të mërkurën është mbajtur debat parlamentar lidhur me arrestimin e kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi. Deputetët e partive në pushtet, ata në opozitë, si dhe anëtarë të kabinetit qeveritar kanë shkëmbyer akuza për dyshime të aferave korruptive brenda Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Opozitarët kanë theksuar se kryeministri Kurti ka mbrojtur njeriun e korruptuar e jo prokurorin sepse, sipas opozitës, Kurti është i shantazhuar prej dostave

## AKTUALE



### EUFOR-i po “vëzhgon nga afër” situatën e sigurisë në Bosnjë

F. 2

### Fare ose pak gjasa për t’u pajtuar për statutin e Asociacionit F. 3

### Kosova inicion aderimin në Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur F. 5

## EKONOMI



### Gërxhaliu: Të stimulohen të punësuarit vendorë në sektorin privat F. 8

### Ndahen 10 milionë euro për zbatimin e masave të efiçiencës së energjisë F. 8

## PENDAROVSKI: MBËSHTETIM ASPIRATAT EUROATLANTIKE TË KOSOVËS FAQE 7



## MBI 200 MIJË FAMILJE PËRFITUESE DHE MBI 88 MILIONË EURO TË KURSYERA NË IMPORT TË ENERGJISË FAQE 8

## SPORT



### Rraci: Mision i vështirë, por jo i pamundur F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# EUFOR po "vëzhgon nga afër" situatën e sigurisë në Bosnjë



**Sarajevë, 26 prill** - Misioni ushtarak i Bashkimit Evropian në Bosnjë-Hercegovinë tha se nuk ka parë asnjë rrezik për situatën e sigurisë në këtë shtet pavarësisht prej tensioneve të shkaktuara nga lideri i serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik, që vazhdimisht kërcënon se entiteti serb do ta kërkojë pavarësinë dhe do t'i bashkohet Serbisë fqinje.
Dodik - që është i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania nën dyshimet për përpjekje për ta destabilizuar shtetin dhe për korrupsion - vazhdimisht ka kërcënuar se do ta kërkojë pavarësinë e Republikës Sërpska nëse Qeveria qendrore e Bosnjës, që është pronare ligjore e aseteve të shtetit, nuk ia bartë pronësinë e aseteve shtetërore entitetit serb.
Më 23 prill Dodiku u zotua se do ta kërkojë bashkimin me Serbinë nëse kjo çështje nuk vendoset në favor të Republikës Sërpska dhe paralajmëroi se policia e këtij entiteti do të patrolluojë kufijtë me entitetin tjetër të Bosnjës, Federatës boshnjako-kroate.
Zëdhënësja e misionit të BE-së, Emer Kelly, tha për "Radion Evropa e Lirë" më 26 prill se Operacioni Althea është duke monitoruar nga afër zhvillimet politike dhe të sigurisë. "Althea e EUFOR-it ka prani në mbarë vendin dhe po kryen patrullime rutinore në mbarë Bosnjë-Hercegovinën në mënyrë që t'i sigurojë të gjitha komunitetet për praninë tonë dhe për ta rritur gatishmërinë për situatën", tha Kelly.
Ajo shtoi se misioni po vazhdon të mbështesë në mënyrë proaktive institucionet partnere të Bosnjës për të ofruar mjedis të sigurt në shtet dhe se ata do të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe të mbajnë kontakte me autoritetet lokale përmes kanaleve zyrtare.
Sipas Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995, që i dha fund luftës në Bosnjë, u krijua një sistem administrativ, sipas të cilit, Bosnja mbetet e ndarë midis Republikës Sërpska dhe Federatës bosnjako-kroate, që lidhen përmes një qeverie të dobët qendrore.
Dodiku po tenton që të ndajë nga qeveria qendrore ushtrinë, policinë dhe administratën tatimore të entitetit serb, veprime që janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Dejtonit.
Operacioni Althea, që zyrtarisht njihet me emrin Forca e Bosnjë-Hercegovinës e Bashkimit Evropian (EUFOR), u themelua më 2004, pasi paraprakisht në shtet kishin vepruar Forca e Stabilizimit (SFOR), Forca e Zbatimit (IFOR) dhe Forca e Mbrojtjes e Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR).
EUFOR është përgjegjës për zbatimin e pjesës ushtarake të Marrëveshjes së Dejtonit dhe për të siguruar paqe. Mandati EUFOR-it, që përfshin edhe përdorimin e forcës, u zgjat për një vit vjeshtën e kaluar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.
EUFOR vazhdimisht ka deklaruar se do ta përdorë forcën ushtarake "nëse siguria dhe mjedisi i qëndrueshëm rrezikohen seriozisht dhe nëse strukturat aktuale të sigurisë rrezikojnë të shpërbëhen".

# PE-ja paralajmëron për ndërhyrjen ruse për krijim tensionesh në Ballkanin Perëndimor




**Bruksel, 26 prill** - Parlamenti Evropian, në një raport kushtuar ndërhyrjes së huaj në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor, e ka dënuar mundësinë që Serbia i ka dhënë kanalit rus "Russia Today" për ta përhapur fushatën e saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
Ky kanal shtetëror i Rusisë është nën sanksionet e Bashkimit Evropian (BE) për shkak se akuzohet se shërben për përhapjen e propagandës së Rusisë, ndërsa në Serbi ka hapur një zyrë dhe një kanal në gjuhën serbe.
Në këtë raport të përpiluar nga një komitet i veçantë i Parlamentit Evropian (PE) për ndërhyrje të jashtme, e që është miratuar të mërkurën në Komisionin e Politikës së Jashtme, nënvizohet nevoja që BE-ja në mënyrë aktive t'i kundërvihet propagandës së aktorëve që kanë qëllime të këqija në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe që kanë për qëllim dëmtimin e interesave dhe të vlerave të BE-së.
Rajoni i Ballkanit Perëndimor në këtë raport vlerësohet si hapësirë në të cilën përballen interesat e ndryshme strategjike dhe se disa vende të rajonit, në veçanti Serbia dhe hapësirat e dominuara nga serbët, janë të ndjeshme ndaj tentimeve për destabilizim.
Raporti përmend përdorimin e investimeve strategjike dhe fushatat e dezinformimit për ta dëmtuar edhe reputacionin e BE-së dhe për t'i penguar proceset demokratike.
Si shembull përmendet edhe fushata që ka për qëllim zvogëlimin e orientimit euroatlantik të qytetarëve të vendeve të rajonit.
Rusia, sipas këtij raporti, përdor ndikimin e saj në Serbi duke tentuar që t'o destabilizojë vendet fqinje, për shembull: "Në Bosnjë-Hercegovinë përmes Republika Sërspkas; në Mal të Zi përmes ndjenjave pro-serbe si dhe Kishës ortodokse serbe; në Kosovë duke përdorur mospajtimet ekzistuese në veri".
Qëllimi i ndërhyrjes ruse, sipas raportit, duhet parë si pjesë përbërëse e një strategjie të promovimit të autoritarizmit në tërë Evropën.
Raporti përmend se si qëndrimet pro-ruse përhapen në rajon përmes medieve serbe dhe hungareze. Sa i përket Serbisë shprehet shqetësim sidomos për faktin se "Serbia është vendi më i përshtatshëm për ndikimin e huaj në Ballkanin Perëndimor, posaçërisht nga Rusia dhe Kina".
Në të njëjtën kohë theksohet edhe fakti se Serbia vazhdon të mos i mbështesë sanksionet e Bashkimit Evropian ndaj Rusisë.

## Gjermania ndal tre avionë luftarakë rusë mbi Baltik

**Berlin, 26 prill** - Tre avionë ushtarakë të Rusisë janë ndaluar në hapësirën ndërkombëtare ajrore mbi detin Baltik, njoftuan forcat ajrore gjermane.
Avionët nuk kishin lëshuar pajisjet që tregojnë të dhëna për fluturimin e tyre.
Gjermania dhe Britania dërguan avionët e tyre për t'i identifikuar dy avionët luftarakë të llojit Sukhoi Su-27 dhe një Ilyushin Il-20, tha ushtria gjermane përmes një postimi në "Twitter".
Autoritetet ushtarake gjermane publikuan fotografi të avionëve rusë.
Avionët ushtarakë rusë rregullisht fluturojnë nga Rusia për në Kaliningrad, që nënkupton se takime të tilla në hapësira ajrore të këtij rajoni janë të shpeshta.
Më herët gjatë këtij muaji, Gjermania ia kaloi përgjegjësitë Britanisë për patrullimin e hapësirës ajrore të NATO-s në Baltik. Avionët e NATO-s mbrojnë hapësirën ajrore në këtë zonë sepse Lituania, Letonia dhe Estonia nuk kanë avionë luftarakë.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Fare ose pak gjasa për t'u pajtuar për statutin e Asociacionit



**PRISHTINË, 26 PRILL** - Gjasat që Kosova dhe Serbia të pajtohen për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në takimin që do ta zhvillojnë udhëheqësit e tyre më 2 maj në Bruksel janë minimale ose fare, vlerësojnë Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, dhe Dushan Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike në Beograd.

Zyrtarë të Bashkimit Evropian(BE) kanë konfirmuar tashmë se më 2 maj, në fokus të takimit ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të jetë edhe çështja e Asociacionit, përkatësisht prezantimi i draft-statutit të Asociacionit i hartuar nga ekipi menaxhues.

"Radio Evropa e Lirë" e pyeti Qeverinë e Kosovës se cilat janë gjasat që Prishtina zyrtare ta pranojë këtë dokument, por nuk mori përgjigje. Ngjashëm nuk u përgjigj as Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

Kurti ka thënë të martën për mediet se puna e Ekipit Menaxhues, i cili përbëhet nga serbë, dhe përmbajtja e statutit nuk janë "edhe aq të njohura". Ai ka thënë se i ka shprehur Bashkimit Evropian gatishmërinë që ta hartojë vetë draft-statutin për Asociacionin, por se nga BE-ja i është thënë se kjo është punë e Ekipit Menaxhues. "Ky ka qenë qëndrimi i ndërmjetësit, ndërsa unë si kryeministër i Kosovës kujdesem për kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe që gjithçka të jetë në funksion dhe në përputhje me qëllimet tona dhe parimet tona", ka thënë Kurti.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se ekipi menaxhues më 2 maj do ta prezantojë statutin për formimin e Asociacionit, por ka shtuar se nuk ka shpresa të mëdha që pala tjetër do ta pranojë atë.

Për këtë Asociacion, Kosova dhe Serbia janë pajtuar me një marrëveshjeje të arritur në Bruksel në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Marrëveshja nuk është zbatuar kurrë, pasi Serbia këmbëngul në kompetenca të gjera për Asociacionin, ndërsa Kosova thotë se ato kompetenca do ta rrezikonin funksionalitetin e shtetit.

## Çfarë dihet për ekipin menaxhues?

Pasi Kosova dhe Serbia kanë arritur Marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe dy vjet më vonë kanë rënë dakord për parimet e formimit të tij, Ministria e Administrimit të Vetëqeverisjes Lokale e Qeverisë së Kosovës ka emëruar ekipin menaxhues në vitin 2016.

Në atë kohë në krye të kësaj ministrie ishte Lubomir Mariq nga radhët e Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që ka mbështetjen e Beogradit. Sot ai është deputet i Kuvendit të Serbisë nga Partia Përparimtare Serbe.

Mariq, i cili ishte koordinator i ekipit menaxhues, caktoi katër persona për ta shkruar statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe: Igor Kallamar, Dejan Radojkoviq, Vinko Radosavleviq dhe Svetisllav Durlleviq.

Kallamar dhe Radojkoviq janë nga Mitrovica e Veriut, ndërsa Radosavleviq dhe Durlleviq janë nga komunat në jug të Lumit Ibër. REL-i e ka pyetur Qeverinë e Kosovës nëse anëtarët e ekipit menaxhues kanë ndryshuar, por nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu, nuk dihet nëse ekipi menaxhues ka hartuar statut të ri.

## Rashiti: Do të ketë proces negocimi për statusin e Asociacionit

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, thotë se takimi i 2 majit në Bruksel do ta shënojë fillimin e zbatimit të marrëveshjes që shpie drejt normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi për zbatimin e së cilës palët janë pajtuar më 18 mars në Ohër.

Prezantimi i draft-statutit të Asociacionit të hartuar nga Ekipi Menaxhues, sipas tij, do të duhej ta shënonte fundin e punës së këtij trupi.

Rashiti thotë se pala e Kosovës nuk do të pajtohet me draft-statutin dhe se oferta e Kurtit që ta hartojë ai vetë atë, nuk do të jetë e pranueshme as nga Serbia, as nga Bashkimi Evropian. Ai thotë se, në kontekst të këtyre mospajtimeve, palët do ta nisin procesin e gjatë dhe të komplikuar të negociatave lidhur me atë se si do të duket dhe finalizohet statuti për Asociacionin. "Besoj se do të jetë një proces negocimi intensiv, se si do të duket ky Asociacion apo vetëmenaxhim, varësisht formës që do të marrë në fund. Por, do të jetë në mes të zeros dhe dhjetës, çfarë Kosova ofron, si dhe 100-shit, çfarë Serbia kërkon. Do të ketë proces negocimi për këtë dhe do të jetë me shumë parametra", thotë Rashiti për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, arritja te një draft përfundimtar për statutin e Asociacionit do të jetë proces i vështirë, për faktin se për Qeverinë e Kosovës do të jetë e vështirë të vendosë përtej kornizës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Kjo gjykatë ka konstatuar në vitin 2015 se Marrëveshja mbi parimet për formimin e Asociacionit - e arritur po atë vit midis Kosovës dhe Serbisë - nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Kosovës, por se pikat kontestuese mund të harmonizohen.

Rashiti kujton se Marrëveshja që shpie drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe aneksi për zbatimin e saj nuk janë formalizuar me nënshkrimin e palëve. Formalizimi, sipas tij, do të krijonte legjitimet ligjor për ndonjë kompromis apo dizajn të ri për Asociacionin. "Do të vijmë në një situatë, gjatë verës dhe më tutje, kur do të na kërkohet formalizimi i Marrëveshjes ose do të vazhdohet me formatin që BE-ja apo faktori ndërkombëtar po pretendon... se do të bëjë sekuencim të zbatimit të marrëveshjeve", thotë Rashiti.

## Janjiq: Sërish ngecje në dialog

Dushan Janjiq nga Forumi i Beogradit për Marrëdhënie Etnike thotë se shtetet perëndimore të cilat mbështetën Marrëveshjen e Ohrit "e shpallën suksesin para kohës". "Është e vërtetë që dokumenti [statuti] është shkruar por, siç do të thoshte populli, mund ta varni në bishtin e maces. Ky është parashikimi im për atë që do të ndodhë më 2 maj", thotë Janjiq për "Radion Evropa e Lirë".

Ai shton se zgjedhjet lokale në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, të cilat u mbajtën më 23 prill, nuk është dashur të mbahen, përpara se të dyja palët të merreshin vesh për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Këto zgjedhje u bojkotuan nga komuniteti serb, pas thirrjes së Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila e ka mbështetjen e Beogradit.

Lista Serbe tha se e mori këtë vendim, pasi nuk janë plotësuar dy kushtet e saj: formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe tërheqja e forcave speciale të Policisë së Kosovës nga veriu e vendit.

Janjiq beson se si pasojë e "bisedimeve të dështuara" për statutin e Asociacionit, do të ketë ngecje të reja në dialogun Kosovë - Serbi. "Të paktën ngecje për disa muaj, me përtëritje të tensioneve", thotë ai.

## BE-ja kërkon urgjentisht Asociacionin

"Radio Evropa e Lirë" iu drejtua BE-së me pyetjet se çfarë pret nga takimi i 2 majit, gjegjësisht nëse të dyja palët do të bien dakord për statutin e formimit të Asociacionit, si dhe cilët janë hapat e ardhshëm nëse do të arrihej marrëveshje.

Në vend të përgjigjeve, BE-ja kërkoi nga REL-i t'i referohet deklaratës së zëdhënësit të saj, Peter Stano, të datës 25 prill. "Bashkimi Evropian, gjatë tërë kohës, ka qenë i qartë kur bëhej fjalë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Këtë e kemi përsëritur në reagimin ndaj zgjedhjeve lokale në komunat në veri të Kosovës - nevojitet urgjentisht formimi i Asociacionit", tha Stano.

Ai kujtoi se Asociacioni është obligim i Kosovës, i pranuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, dhe se të gjitha marrëveshjet duhet të zbatohen.

## "Priten sjellje gjithnjë e më agresive të Serbisë"

Vuçiqi ka thënë më 24 prill se pjesëtarët e komunitetit serb në veri të Kosovës nuk do të kthehen në institucionet e këtij vendi nëse statuti i Asociacionit nuk do të jetë në përputhje me 22 parimet e Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2015.

Këta serbë i braktisën institucionet e Kosovës në shenjë kundërshtimi ndaj një vendimi të qeverisë në Prishtinë për t'i riregjistruar makinat me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Rashiti thotë se, përderisa palët do t'i qasen dialogut me qëndrime të ndryshme, Serbia do të manifestojë sjellje "gjithnjë e më agresive". "Në të gjitha aspektet, duke mos pranuar ta negociojë draft-statutin e Asociacionit, duke penguar kthimin e serbëve në institucione, duke mos respektuar asnjë nga obligimet e saj, duke vazhduar [ndikimin] në çështjet e sigurisë në veri, diskursi që po përdor dhe të gjitha me radhë. Por, jam i bindur se Kosova, me disa hapa, mund ta bëjë faktorin ndërkombëtar përgjegjës absolut në lidhje me sjelljet e Serbisë në raport me Kosovën dhe marrëveshjen", thotë Rashiti.

Këta hapa, sipas tij, janë: puna intensive lidhur me formimin e Asociacionit, puna me serbët e Kosovës dhe krijimi i mekanizmave për kthimin e tyre në institucione, përgatitja e situatës për zbatimin e marrëveshjes së arritur në Ohër, koordinimi me faktorin ndërkombëtar për zbatimin e marrëveshjes, si dhe premtimi se në fund të procesit do të ketë zgjedhje të reja lokale në veri dhe formim zyrtar të Asociacionit.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË PLENARE

# ‘Përplasje’ në mes të pozitës dhe opozitës për zhvillimet e fundit në KEK

Me kërkesë të deputetëve opozitarë të mërkurën është mbajtur debat parlamentar lidhur me arrestimin e kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi. Deputetët e partive në pushtet, ata në opozitë, si dhe anëtarë të kabinetit qeveritar kanë shkëmbyer akuza për dyshime të aferave korruptive brenda Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Opozitarët kanë theksuar se kryeministri Kurti ka mbrojtur njeriun e korruptuar e jo prokurorin sepse, sipas opozitës, Kurti është i shantazhuar prej dostave

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Deputetët e partive në pushtet dhe ata në opozitë, por edhe anëtarë të Qeverisë së Kosovës, kanë shkëmbyer akuza për dyshime të aferave korruptive brenda Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Ky diskutim i debatit u mbajt në një seancë të Kuvendit, e cila u thirr pas kërkesës së deputetëve opozitarë për debat parlamentar lidhur me arrestimin e kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi.

Më 19 prill Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi se Krasniqi është arrestuar nën dyshimet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ushtrim të ndikimit dhe konflikt interesi.

Nga Gjykata e Prishtinës atij i është caktuar një muaj paraburgimi ndërsa, pas arrestimit, pozita e tij në KEK është suspenduar me vendim të bordit të këtij institucioni.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti, duke thënë se ai po e mbron Krasniqin. “Po flasim për dyshime për keqpërdorime marramendëse.. Në çdo vend demokratik, normal, në momentin kur është bërë publik lajmi i arrestimit të shefit të energjisë së Kosovës, që jo për koincidencë, ka qenë shefi për energji në Vetëvendosje, një kryeministër normal do të duhej ta kërkonte shkarkimin imediat të bordit dhe kryeshefit, pa e paragjykuar pafajësinë e tij”, ka thënë Krasniqi.

Ai ka shtuar se keqpërdorimi i 80 milionë eurove është vazhdim i aferave, skandaleve dhe keqpërdorimit të qindra e miliona eurove të tjera të cilat kanë ndodhur gjatë këtyre dy vjetëve në sektorin e energjisë nga kjo qeveri.

Lideri i opozitës ka pohuar se të gjitha këto afera korruptive bashkë shpërfaqin dhe nënkuptojnë dy gjëra: “Qeveria Kurti abuzimet më të mëdha i ka bërë pikërisht në sektorin e energjisë përmes skemave korruptive dhe keqpërdorimit të pushtetit absolut që e kanë instaluar në këtë sektor. Qytetarët e Kosovës sot e kanë jetën më të vështirë dhe jetojnë më keq si pasojë e këtyre abuzimeve, sepse me këto para të cilat janë abuzuar në KEK dhe në tërë sektorin e energjisë, ka pasur mundësi që të bëhen përmirësime të jashtëzakonshme në shumë sektorë”, ka deklaruar Krasniqi.

Deputetë të kësaj partie përmendën edhe kontrata të ndryshme brenda KEK-ut që, sipas tyre, janë lidhur në mënyrë të dyshimtë. Në anën tjetër, Driton Selmanaj, deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha se shkarkimi i Krasniqit nga bordi i KEK-ut u bë me vonesë. “Ne e përshëndetim vendimin e bordit për pezullimin e Krasniqit, mirëpo kjo ka ndodhur vetëm pasi ne kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme”, ka thënë ai.

Sipas tij, arsyeja se pse LDK-ja është bërë pjesë e thirrjes së kësaj seance të jashtëzakonshme ka të bëjë me logjikën kleptokratike abuzuese dhe korruptive që qeveria Kurti ka karshi ndërmarrjeve publike dhe në rastin konkret ndaj KEK-ut. “LDK-ja vlerëson se të gjithë ne duhet të mbështetim çdo aksion të Policisë së Kosovës dhe organeve ndjekëse që kanë për qëllim të luftojnë rastet korruptive dhe aktivitetet kriminale kudo që ato ndodhen”, ka thënë Selmanaj.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj ka thënë se kryeministri Albin Kurti ka mbrojtur njeriun e korruptuar e jo prokurorin. Haradinaj gjatë seancës parlamentare ka theksuar se Kurti është shefi i të korruptuarve. “Albin Kurti personalisht ka intervistuar anëtarë të bordit, ku ka interesa financiare është e pamundur të intervistohet pa Albin Kurtin. Ju mund të thoni që Albin Kurti nuk është i korruptuar, por është shefi i të korruptuarve, pra është krijuesi i korrupsionit të modelit lidhje e shkurtër. Ai ka shprehur mosbesim në të gjithë të tjerët dhe ka besuar që dostat e tij janë të pakorruptuar”, ka thënë Haradinaj.

Sipas tij, Kurti është i shantazhuar, siç i ka quajtur ai, prej dostave. “Kryeministri ka mbrojtur njeriun e korruptuar e jo prokurorin, sepse është i shantazhuar prej dostave. Kjo sjellje e tregon të gjithë kupolën e korrupsionit. Unë besoj shumë se këta njerëz e kanë një zor të madh që vijnë në këtë foltore e mbrojnë të korruptuarin. Kryeministër,

# Ministri Vitia thotë se objektivi i qeverisë është për shërbime cilësore dhe të avancuara për pacientët

Prishtinë, 26 prill - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku me u.d drejtoreshën e ShSKUK-së, Narqize Arenliu-Hoxhaj, mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Shoqata e Urologëve të Kosovës dhe Klinikës së Urologjisë ku për herë të parë në Kosovë u realizuan intervenimet laparoskopike, (nefrektominë radikale dhe cistën parapielike të veshkës). Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin edhe profesorë nga “FIRAT University” nga Turqia.
Me këtë rast, ministri Vitia i falënderoi të pranishmit për punën e bërë si dhe stafin nga Turqia që përmes ndarjes së përvojës sjell te ne praktikat dhe metodologjitë më të avancuara dhe bashkëkohore. Ai tha se do të jetë përkrahë profesionistëve shëndetësorë në secilën iniciativë që do të mundësojë shërbime cilësore për pacientët, bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira mjekësore. “Tashmë në QKUK, në Klinikën e Urologjisë, falë angazhimit të profesionistëve shëndetësorë, janë funksionalizuar shërbimet laparoskopike, duke realizuar ndërhyrjet e para, gjë që dëshmon se me hapa të vegjël, por të sigurt, bëhen ndryshimet e mëdha të cilat do të vulosen me punën e juaj, - brezave të rinj, që do të jeni specialistë në të ardhmen. Si Ministri e Shëndetësisë mbesim të përkushtuar që në qendër të



vëmendjes të jetë pacienti dhe shërbimet të cilat do t’i ofrohen. Trajnimi i stafit shëndetësor, furnizimi me pajisje dhe aparaturë moderne, mbeten një prej objektivave kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë”, tha ministri Vitia.
Ministri Vitia theksoi se sistemi i shëndetësisë është një prej prioriteteve të Qeverisë së Kosovës, gjë që dëshmohet edhe me rritjen e buxhetit që është më i larti deri më tani si dhe planifikimi për investime në vlerë të mbi 41 milionë euro në kuadër të Planit Strategjik për ngritjen e infrastrukturës dhe pajisjeve për kujdesin dytësor dhe tretësor.
Këto intervenime u transmetuan në kohë reale në Qendrën e Telemjekësisë në ShSKUK, nga Salla e Operacioneve në Klinikën e Urologjisë - ShSKUK, ndërsa nga kjo përvojë patën mundësi të përfitojnë të gjithë profesionistët shëndetësorë nga spitalet e përgjithshme në qytete të ndryshme të Kosovës.

# Kosova inicion aderimin në Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

**Prishtinë, 26 prill** - Qeveria e Kosovës ka miratuar një projektligj që mundëson nisjen e procedurave për anëtarësimin e Kosovës në Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), me seli në Hagë.
Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë mbledhjes së ekzekutivit të mërkurën, tha se aderimi në këtë komision do t’i rrisë mundësitë e bashkëpunimit rajonal për procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur. Sipas të dhënave zyrtare të institucioneve të Kosovës, 1 617 persona konsiderohen të zhdukur me forcë që nga lufta e fundit në Kosovë më 1998/99.
Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se ICMP-ja ka qenë e angazhuar në Kosovë që nga vitet e para të pasluftës. “Kosova, me aderimin në këtë komision, zgjeron rrjetin e organizatave ndërkombëtare në të cilat është anëtare dhe konsolidon subjektivitetin juridiko-ndërkombëtar, vepron në bazë të konkluzave të aprovuara në samitin e Londrës më 2018 për Ballkanin Perëndimor, ku është përkrahur prioritizimi i çështjes së personave të zhdukur. Prandaj, aderimi i Kosovës në këtë organizatë do t’i jepte shtysë zbardhjes së fatit të personave të zhdukur”, shtoi Bislimi.
Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur është organizatë ndërkombëtare, por nuk është pjesë e sistemit të Kombeve të Bashkuara.
Mandati i këtij komisioni është ta ofrojë bashkëpunimin e qeverive dhe autoriteteve të tjera me synim të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur.
Në luftën e fundit në Kosovë janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur, kryesisht shqiptarë.



# Replikë e ashpër ndërmjet Haxhiut dhe Haradinajt

Një replikë e ashpër ka ndodhur gjatë seancës ndërmjet kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj dhe ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kur po diskutohej për zhvillimet e fundit në Korporatën Energjetike të Kosovës, rrjedhimisht për korrupsion dhe ndërhyrjen në sistemin e drejtësisë. Haradinaj theksoi para deputetëve se kryeministri Albin Kurti ka mbrojtur njeriun e korruptuar, e jo prokurorin.
Pas kësaj deklarate ka reaguar ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, duke ia rikujtuar Haradinajt rastin e prokurorit special Elez Blakaj. “Ndoshta ju kujtohet që një prokuror special është detyruar ta lëshoj vendin për shkak teje, zotëri Haradinaj. Sa ke qenë kryeministër ti i ke kërkuar raport me shkrim që brenda 30 dite të të japë informacion për lëndët që i kishte në adresim ish-prokurori Elez Blakaj. Kjo është ndërhyrja brutale në sistemin e drejtësisë…”, u shpreh Haxhiu.
Pas deklaratës së ministres, ka reaguar sërish i pari i AAK-së. “Unë po i them Kosovës siç vijon. Albin Kurti me vetëdije ka krijuar koncept politik, Lëvizjen Vetëvendosje çfarë e ka krijuar. Pra, me vetëdije ka krijuar modelin e korrupsionit ‘lidhje e shkurtër e dostave’. Aty janë të përshirë vetëm njerëzit e besueshëm të tij… një prej tyre është ministrja… dost.. e shohim sa është i përfshirë në të tjerat… mos shkoni në këtë rrugë të korrupsionit se keni për të pësuar me ata që janë të përfshirë…”, ka deklaruar Haradinaj.

bëhu me ligjin dhe me prokurorin”, ka përfunduar Haradinaj.
Kritikave të opozitës u janë përgjigjur deputetët e partisë në pushtet dhe pjesëtarët e qeverisë, duke thënë edhe se në kohën e qeverive të kaluara ka pasur shumë keqpërdorime në sektorin e energjisë.
Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, e fajësoi opozitën për ndërhyrje në sistemin e drejtësisë. “Jam më se e bindur se drejtësia do të triumfojë, gjithashtu jam e bindur se kërkesa për këtë diskutim bëhet me qëllim për ta tërhequr vëmendjen nga sukseset për të cilat sot do të duhej të krenohej i tërë vendi”, tha ajo duke iu referuar vendimit për liberalizim të vizave dhe shtyrjen përpara të aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.
Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka përmendur të arriturat dyvjeçare të Korporatë Energjetike (KEK), mirëpo nuk ka komentuar arrestimin e kryeshefit të kësaj ndërmarrjeje, Nagip Krasniqi.
Rizvanolli gjatë seancës plenare ka thënë se me investimet që po bëhen në KEK do të sigurohen që termocentralet të jenë në funksion në 20 vitet e ardhshme. “Dje Bordi i KEK-ut ka pezulluar nga detyra kryeshefin Nagip Krasniqi deri në një vendim të ardhshëm. Ndërkohë, për ta siguruar mbarëvajtjen e ndërmarrjes, Bordi ka emëruar Përparim Kabashin ushtrues detyre. Menjëherë pas kësaj, mbrëmë kemi vizituar termocentralet e KEK-ut, ku u informuam për mbarëvajtjen e punëve nga Kabashi”, ka theksuar Rizvanolli, duke shtuar se aktualisht KEK-u operon me dy blloqe të ‘Kosova A’ dhe ‘Bllokun B1’. “Sivjet dhe në dy vitet e ardhshme jemi në një periudhë kritike në KEK, sepse me investimet që po bëjmë do të sigurojmë që termocentralet të jenë në funksion për 20 vjetët e ardhshëm”, theksoi ajo.
Ministrja Rizvanolli ka shtuar se KEK-u e ka mbyllur vitin 2022 me shumë suksese, duke përfshirë fitimin rekord prej 107.7 milionë eurosh dhe duke depozituar 250GWh te KESh-i, të cilat ua kanë kursyer qytetarëve të Kosovës mbi 50 milionë euro.
Deputetë nga partitë opozitare edhe më herët e kanë bërë përgjegjëse Qeverinë e Kosovës për “skandalin e Nagip Krasniqit” meqë, sipas tyre, ai ka qenë pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje, partisë në pushtet.
Korporata Energjetike e Kosovës është një ndër ndërmarrjet kryesore energjetike në vend. Asetet e korporatës janë nën pronësi të plotë të Qeverisë së Kosovës.

# Vizitohen disa biznese prodhuese në Podujevë që kanë përfituar nga subvencionimi

PODUJEVË, 26 PRILL - Drejtori për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik në komunën e Podujevës, Vigan Salihu, i shoqëruar edhe nga dy anëtarët e komisionit, Mimozë Restelica dhe Rilind Babatinca, kanë vizituar bizneset "Nota Cakes", mobilierinë "Qaza", "Fresh Farm Sh.P.K", "Bujari Al Pvc" dhe "Alko Sh.P.K", të cilat janë përfituese nga komuna për projektin e subvencionimit të investimeve në kapacitete prodhuese. Nga ky projekt janë gjithsej 16 biznese përfituese, ku shuma maksimale e subvencionit ka qenë 10 000 euro. Drejtori Salihu gjatë vizitave tha se është hera e parë që kemi filluar me këtë formë të mbështetjes për bizneset prodhuese në shtim të kapaciteteve të tyre prodhuese, si dhe tha se ndihet shumë i lumtur që po arrijmë t'i ndihmojmë bizneset lokale në fuqizimin e tyre në prodhim dhe në gjenerim të vendeve të reja të punës.





# Nëntë doktorë dhe 20 infermierë të rinj nisin punën në Malishevë

Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka bërë me dije se nëntë doktorë dhe 20 infermierë të rinj nisën punën në Malishevë. "Ditën e sotme e nisa bashkë me doktorët dhe infermierët e rinj, që sapo kanë nisur punën në Qendrën Kryesor të Mjekësisë Familjare në Malishevë

MALISHEVË, 26 PRILL - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka bërë me dije se nëntë doktorë dhe 20 infermierë të rinj nisën punën në Malishevë. "Ditën e sotme e nisa bashkë me doktorët dhe infermierët e rinj, që sapo kanë nisur punën në Qendrën Kryesor të Mjekësisë Familjare në Malishevë. I shpreha urimet më të mira gjithë stafit të ri që sapo ka nisur misionin fisnik në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët tanë dhe e sigurova që do ta ketë përkrahjen e vazhdueshme të qeverisjes sonë komunale", ka njoftuar kryetari i Malishevës.

# Kryetari i Gjilanit: Edhe këtë vit vazhdon kampanja e pastrimit 'Green and Clean'

GJILAN, 26 PRILL - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se edhe këtë vit vazhdon kampanja e pastrimit "Green and Clean". Hyseni tha se qëllimi i kësaj kampanje është që komuna e Gjilanit të shndërrohet në një prej komunave më të pastra dhe më ekologjike në Kosovë.

Kjo kampanjë përfshin një varg aktivitetesh që do të mbahen në lokacione të ndryshme dhe do të zgjasë deri më 5 qershor 2023. Pastrimi i rrugëve, lagjeve dhe fshatrave; Pastrimi i institucioneve komunale, arsimore dhe shëndetësore; Pastrimi i shtretërve të lumenjve; Eliminimi i deponive ilegale; Mbjellja e drunjve dekorativë në disa zona të qytetit; Shtimi i numrit të kontejnerëve të mbeturinave; Pastrimi i pendës së Livoçit dhe Përlepnicës; Dita Botërore e Biçiklistëve (lëvizim pa vetura); Hiking.

Kryetari Hyseni u bëri thirrje përfaqësuesve institucionalë e politikë si dhe të gjithë qytetarëve që të bëhen pjesë e kësaj kampanje në mënyrë që kjo të bëhet më masive për nga pjesëmarrja dhe më efektive në terren.



## Arrestohet një person i cili kërkohej me urdhërarrest ndërkombëtar

PRISHTINË, 26 PRILL - Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën në mbrëmje rreth orës 23:00, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës është arrestuar personi M. M., mashkull, 59 vjeç, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili ishte në kërkim me urdhërarrest ndërkombëtar. Përderisa personi në fjalë është dërguar në qendrën e mbajtjes, zyrtarët policorë të stacionit të Lipjanit po i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në koordinim me Njësitin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe institucionet përkatëse lidhur me procedimin e mëtejmë të tij.



# Miratohet raporti për Kosovën në Komisionin e Parlamentit Evropian



**Prishtinë, 26 prill** - Komisioni për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar të mërkurën raportin për Kosovën dhe amendamentet e paraqitura nga deputetët për këtë raport.

Drafti i raportit ishte paraqitur nga Viola Von Cramon-Taubadel, që është raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian(PE), ndërsa në këtë raport janë paraqitur mbi 300 amendamente nga deputetë të ndryshëm.

Raporti për Kosovën u miratua me 44 vota për, tetë kundër dhe tri abstenime, raporton REL.

Raporti përmban pikat e përgjithshme ngjashëm me raportet e viteve të shkuara, por ka marrë parasysh edhe zhvillimet që kanë ndodhur ndërkohë. Me këtë raport mirëpritet aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, që reflekton orientimin pro-evropian të qytetarëve të saj dhe përcaktimin e qartë gjeopolitik.

Ndërkaq, është përshëndetur edhe vendimi i shumëpritur për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, i cili proces u përmbyll të martën, më 25 prill, kur vendimi u botua në Gazetën Zyrtare të BE-së, pasi më herët ishte nënshkruar nga Parlamenti dhe Këshilli i BE-së.

Parlamenti Evropian ka insistuar për shumë vjet që liberalizimi i vizave të bëhet sa më shpejt. Së fundi u arrit pajtimi edhe mes PE-së dhe Këshillit të BE-së për këtë çështje.

Një thirrje që Parlamenti Evropian e përsërit secilin vit në raportet për Kosovën, është përfshirë në tekst edhe kësaj radhe. Kjo është thirrja për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. "Ftohen vendet anëtare, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën shtet sovran, që ta bëjnë një gjë të tillë".

Pikërisht për këtë pikë janë paraqitur shumë amendamente, sidomos nga deputetët nga Spanja dhe vendet e tjera që nuk e njohin Kosovën, duke tentuar që referencat për shtetësi të Kosovës të hiqen nga raporti.

Sa i përket situatës në Kosovë, në tekst thuhet se Kosova pa pasur një periudhë të stabilitetit politik pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe u bënë ftesë autoriteteve të Kosovës që të ndërmarrin më shumë veprime për t'u përballur me sfidat gjatë rrugëtimit evropian.

Edhe këtu përsëritet se "dinamika e procesit të integrimit do të varet nga progresi që do të arrijë për sundimin e ligjit, të drejtave themelore dhe normalizimin e raporteve me Serbinë".

Parlamenti Evropian përshëndet përshtatjen e Kosovës me qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë, sidomos dënimin e ashpër të agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës dhe zbatimin e sanksioneve ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë.

Gjithashtu, PE-ja mbështet edhe aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe planin e vendit për t'u përfshirë në programin e Partneritetit për paqe të NATO-s.

Në këtë tekst, po ashtu, përshëndetet përkushtimi për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por shprehet shqetësim për gjendjen e gjyqësorit në Kosovë që, sipas tekstit, "vazhdon të jetë joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndërhyrjes së panevojshme politike".

Keqardhje shprehet për ndikimin negativ që ka pasur atmosfera e polarizimit politik në punën e Kuvendit dhe u bëhet ftesë deputetëve të opozitës që t'i japin fund praktikës së abstenimit.

Sa i përket lirisë së shprehjes në Kosovë, në tekst përshëndetet fakti se në Kosovë "ka një mjedis të gjallë pluralist medial", por shprehet shqetësim për fushata të sulmeve ndaj gazetarëve hulumtues. Në veçanti shqetësim ngrihet për mungesën e lirisë së shprehjes në veri të Kosovës dhe dënohen ashpër sulmet ndaj gazetarëve në komunat veriore.

Në raport bëhet thirrje edhe për një angazhim të sinqertë të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të serbëve të Kosovës për një dialog i cili do ta forconte besimin e ndërsjellë.

Sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që zhvillohet në Bruksel me lehtësimin e BE-së, përsëritet thirrja që të dyja shtetet të angazhohen në frymën e kompromisit për të arritur "një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese për normalizimin e raporteve, të bazuar në njohjen e ndërsjellë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare".

Po ashtu, bëhet thirrje edhe për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tash në dialog, përfshirë edhe atë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Nga BE-ja kërkohet që ta bëjë më dinamik procesin e zgjerimit duke e quajtur këtë si politikën më të suksesshme të BE-së për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në Evropë.

Deputetët e Parlamentit Evropian përmes propozimeve për amendamente kanë kërkuar që të forcohet roli i BE-së në rajon.

# Pendarovski: Mbështetim aspiratat euroatlantike të Kosovës

"Epoka e re"

**Shkup, 26 prill** - Presidentja Vjosa Osmani ka vizituar të mërkurën Maqedoninë e Veriut. Ajo është pritur me nderime të larta shtetërore dhe ushtarake nga presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i cili, në një konference për medie, pas takimit me Osmanin, ka thënë se dy shtetet kanë një vend të rëndësishëm në rolin e tyre aktiv në përpjekjet e përbashkëta për të arritur stabilitet të qëndrueshëm, fqinjësi të mirë dhe prosperitet ekonomik në këtë pjesë të Evropës. "Ne mbështetim aspiratat euroatlantike të Kosovës dhe jemi të gatshëm t'i ndajmë përvojat tona në lidhje me proceset reformuese. Ne mbështetim vendimin e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe pjesëmarrjen e Kosovës në formate të ndryshme rajonale të bashkëpunimit. Po ashtu, mirëpretim marrëveshjen e arritur për ta pranuar propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zbatimi i të cilit do të kontribuojë për paqen, stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin jo vetëm për fqinjët tanë, por për rajonin në tërësi", ka thënë Pendarovski.

### Osmani kërkon që Serbisë t'i bëhet presion që ta respektojë Marrëveshjen e Ohrit



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kërkoi nga Bashkimi Evropian dhe aleatët e tjerë të Kosovës që t'i bëjnë presion Serbisë, që t'i respektojë obligimet që ka marrë nga Marrëveshja drejt normalizimit të raporteve. Gjatë vizitës zyrtare në Maqedoninë e Veriut, Osmani tha se Serbia me veprimet e fundit ka bërë "shkelje flagrante" të dy neneve të Marrëveshjes drejt normalizimit, që u arrit në fund të shkurtit në Bruksel, dhe të aneksit të saj, që u arrit një muaj më vonë në Ohër.

Kjo marrëveshje synon t'i çojë palët drejt normalizimit të plotë të raporteve.

Ajo tha se në raundin e ri të dialogut, që mbahet më 2 maj në Bruksel, Kosova do të ketë qasje konstruktive dhe të hapur. "Se cilat do të jenë veprimet e Serbisë, pak a shumë mund t'i nuhatim nga deklaratat e fundit, mbi të gjitha nga veprimet të cilat kanë qenë shkelje e marrëveshjes të arritur në Bruksel dhe aneksit në Ohër. Siç e dini, neni 4 i kësaj marrëveshjeje parasheh që Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare. Sjellja e tyre të hënën në Këshillin e Evropës, por edhe lobimi i tyre kundër votimit pro Kosovës, e ka dëshmuar këtë shkelje flagrante. Natyrisht, edhe ndërhyrja e tyre e paligjshme në zgjedhjet në Kosovë, është edhe shkelje e nenit 2 të kësaj marrëveshjeje", tha Osmani gjatë konferencës për medie me homologun e saj maqedonas, Stevo Pendarovski.

# Gërxhaliu: Të stimulohen të punësuarit vendorë në sektorin privat

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**




**Prishtinë, 26 prill** - Ish-drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se duhet të stimulohen të punësuarit vendorë në sektorin privat. "Duhet të stimulohen të punësuarit vendorë në sektorin privat, importimi i fuqisë punëtore nga jashtë është sfidë!?", ka shkruar ai në "Facebook", duke theksuar se ditët e fundit në mediet kroate dominojnë titujt si "Nepalezët krijojnë sindikatë dhe adresojnë pakënaqësitë me kushtet e punës". "Në medie të tjera dominojnë, po ashtu, titujt me pakënaqësitë e të punësuarve të ardhur nga Filipinet!!? Në qoftë se në vende evropiane si Kroacia ka reagime të tilla, atëherë lind pyetja se sa do të jenë të kënaqur eventualisht në Kosovë!? Në debatet televizive vendore nga ana qeveritare promovohet zhvillim ekonomik enorm pozitiv në të gjithë parametrat. Në anën tjetër Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtare e vlerësojnë Shqipërinë dhe Kosovën si vendet më të varfra jo vetëm sot, por edhe në dhjetë vitet e ardhshme", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se kjo është një situatë sa shqetësuese po aq dhe kontradiktore. "Agjenda politike e ngulfat çdo ditë e më tepër perspektivën zhvillimore të Kosovës, e mungesa e stabilitetit politik në Kosovë po i demotivon investitorët e huaj të vijnë në Kosovë. Pandemia demografike është sëmundja më e rrezikshme që e ka kapluar Kosovën dhe po merr përmasa shqetësuese. Ikja nga Kosova e të rinjve është alarmante, në veçanti kur në vitin e kaluar zyrtarisht janë evidentuar afër 60 000 ikje!?", ka thënë Gërxhaliu.

Ish-drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës ka thënë se sektori privat është shtylla e qëndrueshmërisë së shtetit. Ai ka theksuar se nevoja për fuqi punëtore në këtë sektor po rritet çdo ditë e më tepër. "Alternativa që po dëgjohet më së shumti për të zgjidhur këtë problem është importimi i fuqisë punëtore nga vende të ndryshme të botës, në veçanti nga Nepali, Filipinet, Pakistani etj", është shprehur ai.

Gërxhaliu, i cili është edhe themelues i kompanisë këshilluese biznesore EK-Consulting, ka thënë se është e rrugës të avancohet një dialog më i avancuar publiko-privat dhe të përmirësohen kushtet e punës dhe të rriten pagat në sektorin privat. Në këtë drejtim ai ka thënë se është shumë më e lehtë dhe më produktive sesa kostoja e importimit të fuqisë punëtore nga jashtë.

"Inspektorati i Punës le t'i vizitojë marketet, kompanitë e sigurimit të objekteve, kompanitë për pastrim, restorantet dhe kateteritë, disa medie etj. Besoj se do të jetë shqetësuese kur të kuptohet e vërteta e pagave në këta sektorë. Prandaj të rinjtë ikin nga kjo pakënaqësi. Të importoni fuqi punëtore nga jashtë ka kosto jo vetëm financiare, por edhe edukative, duke filluar nga trajnimet, gjuha, kultura, tradita e punës etj. Prandaj t'i rrisim pagat dhe t'i përmirësojmë kushtet e punës për fuqi punëtore vendore është shumë më racionale sesa të mendohet vetëm në punëtorë të huaj. Janari i vitit 2024 vjen shpejt e liberalizimi fillon së zbatuari, prandaj të veprojmë sot që mos të jetë vonë atëherë", ka thënë Gërxhaliu.

# Mbi 200 mijë familje përfituese dhe mbi 88 milionë euro të kursyera në import të energjisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 26 prill** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, kanë mbajtur të mërkurën një konferencë për medie lidhur me përmbylljen e suksesshme të masës për kursimin e energjisë.

Ministri Murati u shpreh se mjetet për zbatimin e kësaj mase për periudhën shtator - nëntor janë alokuar nga buxheti i shtetit, ndërsa pas diskutimeve me Bashkimin Evropian, periudha dhjetor - mars, në vlerë prej 15 milionë eurosh, është mbuluar nga Pakoja mbështetëse e BE-së.

Më tutje, ministri tha se zbatimi i masës për kursimin e energjisë i ka kursyer buxhetit të shtetit mbi 88 milionë euro nëse krahasojmë shpenzimin e energjisë për periudhën mbështetëse me shpenzimin e energjisë në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në anën tjetër, shefi i Zyrës së BE-së, Tomas Szunyog, tha se suksesi i jashtëzakonshëm i kësaj mase të qeverisë e ka shtyrë BE-në që në kuadër të pakos mbështetëse të energjisë, të subvencionojë një pjesë të zbatimit të kësaj mase. Ambasadori, gjithashtu, shprehu përkushtimin e BE-së për mbështetjen dhënë Kosovës drejt dekarbonizimit dhe energjisë eficiente.

Në kuadër të masës për kursimin e energjisë elektrike janë mbështetur rreth 200 mijë familje në muaj, ndërsa përmbyllja e zbatimit të saj përkon me përmbylljen e sezonit dimëror.

Qeveria e Republikës së Kosovës së shpejti do ta njoftojë publikun lidhur me masat e reja që synojnë subvencionimin e energjisë elektrike për familjet.




Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në linjë me Programin e Qeverisë, mbetet e përkushtuar për zbatimin e politikave që synojnë ngritjen e mirëqenies qytetare në vend.

## Ndahen 10 milionë euro për zbatimin e masave të efiçiencës së energjisë



**Prishtinë, 26 prill** - Qeveria në mbledhjen e fundit ka marrë vendim që t'i ndajë 10 milionë euro për Fondin Kosovar për Efiçiencë të Energjisë (FKEE) në kuadër të masave të zbatimit të efiçiencës së energjisë. Sipas arsyetimit të ministrit të Financave, Hekuran Murati, këto mjete do të mundësojnë rinovimin për ndërtesat e banimit social në gjithë territorin e Kosovës. "Ndarja e shumës prej 10 milionë eurosh për Fondin Kosovar për Efiçiencët të Energjisë (FKEE), në mënyrë që të subvencionohet izolimi dhe masat e tjera për efiçiencën e energjisë në ndërtesat e banimit social në të gjithë Kosovën", tha Murati, duke shtuar se kjo masë është në kuadër të planit të veprimit, që parasheh shtrirjen e mbështetjes së pakos së Bashkimit Evropian për tejkalimin e krizës energjetike në vlerë prej 75 milionë eurosh.

# Rreh miliarda herë në jetë pa asnjë pushim, misteret e funksionimit të zemrës



Nga Matt HRODEY

Zemra është ndoshta organi më elastik i trupit, dhe bashkë me trurin, është më i rëndësishmipër jetën e njeriut. Zemra e grave, e cila peshon rreth 230 gramë, rreh 100.000 herë në ditë (2.5 miliardë herë në jetë), duke e pompuar gjakun me forcën e nevojshme sa për të shtrydhur një top tenisi.

Kaq gjak mjafton që gjatë jetës së një 80-vjeçareje të mbushë 100 pishina me përmasa olimpike. Për të ruajtur këtë ritëm marramendës, zemra ushqehet nga furnizimi i saj me gjak, duke konsumuar rreth 5 për qind të oksigjenit të trupit, ndërsa përbën rreth 0.5 për qind të masës së tij.

Në bazë të peshës, zemra ka kërkesat më të mëdha për energji se çdo organ tjetër i njeriut.

"Zemra është ndoshta organi më aerobik që kemi"– thotë Geri Lopashuk, profesor në Qendrën e Kërkimeve Kardiovaskulare në Universitetin e Albertës, Kanada.

Qëllimi i vetëm i zemrës është të tkurret, duke dërguar gjak çdo ditë nëpër 96.000 km enë tëpërmasave të ndryshme. Ajo është aq e përkushtuar ndaj këtij misioni, saqë vazhdon të rrahë edhe pasi të ketë vdekur truri, siç ndodh me dukurinë e "kufomave me zemra që rrahin". Në këtë rast, trupat mbahen gjallë me oksigjen dhe lëndë ushqyese, në mënyrë që organet të mund të merren për transplantim. "Ju mund ta hiqni zemrën nga trupi, dhe ajo do të rrahë ende nëse i jepni karburantin e duhur"- thekson Lopashuk. Po si funksionon ky organ?

Në pjesën më të madhe, zemra mbështetet tek oksigjeni për të prodhuar adenozin trifosfatin(ATP), një burim thelbësor i energjisë. Rezervat e saj të energjisë qëndrojnë në një ekuilibër delikat:pa sasi të re ATP-je, rezervat mbarojnë për 2–3 sekonda dhe muskuli i zemrës nuk mund të tkurret më, duke shkaktuar një atak në zemër.

Për ta mbrojtur veten nga mungesa, zemra punon duke marrë infuzione të qëndrueshme të gjakut të oksigjenuar nga mushkëritë aty pranë. Për të mbrojtur më tej veten, zemra ka nevojë për lëndë ushqyese për të prodhuar energji, përfshirë acidet yndyrore, karbohidratet, proteinat dhe ketonet.

"Zemra është një omnivor. Ajo do të përdorë pothuajse çdo lloj energjie"- nënvizon eksperti.Acidet yndyrore përbëjnë deri në 90 për qind të prodhimit të ATP-së, pasi ofrojnë një burim të besueshëm energjie, por zemra ka një plan rezervë. Gjatë periudhave të kequshqyerjes, ajopërdor rezervat e glukozës dhe riciklon molekulat e laktozës, për të marrë energjinë që i nevojitet.

Me energjinë që merr, zemra e vazhdon punën e saj të pavarur nga truri, me një ritëm bazë që varion nga 60 deri në 100 rrahje në minutë, në varësi të individit. Ashtu si gjitarët e tjerë, njerëzit kanë një grup të veçantë qelizash të zemrës, të ndërtuara për të prodhuar një sinjal elektrik të rregullt, që e transmetojnë atë tek gjithë zemra.

Duke ndjekur rrugë të veçanta, sinjali kontrakton atriumet e sipërme dhe më pas barkushet e poshtme për të pompuar gjakun nga zemra. Me përjashtim të vdekjes apo ndërlikimeve të tjera, ky proces nuk ndalet asnjëherë. Qelizat e stimuluesit kardiak, thithin në mënyrë të përsëritur jonet e natriumit, duke i bërë ata të aktivizohen siç ndodh me neuronet, duke dërguar sinjal pas sinjali.

Një studim i vitit 2014, përshkruan një eksperiment në të cilin studiuesit kultivuan qeliza kardiake nga qelizat burimore njerëzore, dhe panë se si ato "vetë-montoheshin" në një pjesë të hollë indi kardiak që "rrihte spontanisht". Ky proto-organ punoi me rreth 70 rrahje në minutë, brenda intervalit normal, për rreth 1 muaj.

Edhe kur zemra funksionon keq, ajo e vazhdon punën me pak ose aspak efekte anësore të rënda. Gati 45 për qind e të gjitha sulmeve në zemër prodhojnë efekte të buta "të heshtura",që të sëmurët i ngatërrojnë me një gjendje tjetër, siç është lodhja fizike ekstreme.

Në disa raste, qelizat e stimuluesit kardiak mund të ndalojnë përkohësisht dhe të kenë një "pauzë sinusoidale" beninje, përpara se të vazhdojnë punën si më parë. Ose mund të shfaqin një ritëm të pazakontë, një gjendje që mund të mos kërkojë trajtim mjekësor.

Kështu në vitin 2012, një ritëm i paprecedentë preku zemrën e një pacienti në Spitalin Shën Vincent në Uorçester të Bostonit, SHBA, më një normë 600 rrahje në minutë, ose rreth 10 herë më shumë se sa ritmi i zakonshëm. Deri atëherë, ekspertët mendonin se rrahjet maksimale të zemrës mund të arrinin deri në 300 në minutë.

Megjithatë për 20 sekonda, një 57-vjeçar tetraplegjik kishte prodhuar një elektro–kardiogramqë i ngjante majave të një krehri me dhëmbë të imët. Në fillim, ai ishte shtruar në spital pasi vuante nga dhimbjet e gjoksit dhe qëndroi disa netë pasi gjendja e tij u përmirësua. Më pas dhimbjet i nisën sërish, dhe mjekët zbuluan një aritmi në zonat atriale dhe ventrikulare të zemrës së tij.

Pas një dhimbje të fortë në gjoks, burri humbi ndjenjat, dhe leximi i rimit të zemrës së tij nisi të rritet çdo 100 milisekonda, aq shpejt sa mund të pulsojë syri mesatar i njeriut. Pas rreth 20 sekondash, shkalla e rrahjeve ra nga 600 në 300, dhe papritmas në një nivel normal.

Pas dy ditësh rrahje zemre të jashtëzakonshme, burri doli nga spitali, teksa mjekët mbetën ende të habitur se si një zemër njeriu kishte rrahur me një ritëm prej rreth 10 herë në sekondë. Kryqëzimi atrioventrikular, mund të aktivizohet vetëm çdo 0.2 sekonda, duke kufizuar rrahjet e zemrës në rreth 300 rrahje në minutë. Atëherë, çfarë e kishte lejuar aritminë të dilte jashtë kontrollit? Mjekët hipotetizuan se burri duhet të ketë pasur lidhje të pazakonta elektrike në zemrën e tij, së bashku me një lloj shqetësimi nervor autonom që lidhet me kuadriplegjinë e tij.

Rastet e rrahjeve të zemrës mbi 300 janë të rralla, por jo të padëgjuara. Në vitet 1940, rrahjet e zemrës së një gruaje u rritën në 310 në minutë dhe qëndruan në atë nivel për rreth 12 orë pa i marrë jetën. Në një rast tjetër u regjistruan 303 rrahje në minutë për një ditë e gjysmë.

Në vitin 2018, një djalë 10-vjeçar anglez regjistroi 301 rrahje në minutë dhe sërish mbijetoi, një rezultat i një shtegu të veçantë të sinuseve në zemrën e tij. Nga rasti i 600 rrahjeve përminutë, mjekët nuk mësuan asgjë më shumë, pasi burri refuzoi t'i nënshtrohej një studimi elektrofiziologjik,për të testuar funksionimin elektrik të zemrës së tij. Megjithatë ata e dinin:masat e tij mbrojtëse e kishin nxitur punën e pazakontë të zemrës për 20 sekonda,përpara se të rikthehej në normalitet. / "Discover Magazine" – Bota.al




# Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Rraci: Mision i vështirë, por jo i pamundur



### ORARI I KOSOVËS PËR FIBA EUROBASKET 2025

**19 korrik**
KOSOVA-ZVICRA

**22 korrik**
ZVICRA-DANIMARKA

**26 korrik**
DANIMARKA-KOSOVA

**29 korrik**
ZVICRA-KOSOVA

**2 gusht**
DANIMARKA-ZVICRA

**5 gusht**
KOSOVA-DANIMARKA

Prishtinë, 26 prill - Kosova ka mësuar kundërshtarët në Rrethin e Tretë Parakualifikues për EuroBasket 2025. "Dardanët" do të përballen me Zvicrën dhe Danimarkën, ndeshje që do të zhvillohen nga 19 korriku deri më 5 gusht. Menaxheri i Përfaqësueseve të Kosovës, Adriatik Rraci, ka folur për shortin. "Shorti ka qenë relativisht i favorshëm, pasi ka pasur kombëtare shumë më të forta, duke theksuar Kombëtaren e Kroacisë. Danimarka dhe Zvicra janë kombëtare të forta, shumë mirë të organizuara dhe me cilësi të larta", është shprehur Rraci për faqen zyrtare të FBK-së. Ai shpreson që kësaj radhe të mos kemi lëndime. "Ka një kohë që kemi filluar përgatitjet dhe pas hedhjes së shortit do t'i përvishemi punës dhe në këto kualifikime të hyjmë me synime të qarta. Në vitet e fundit kemi qenë të hendikepuar, pasi asnjëherë nuk kemi qenë të kompletuar. Nëse jemi kompletë, atëherë shanset tona, veçanërisht për përkrahjen e Dardanëve në shtëpi, mund të jenë të larta", ka shtuar Rraci. Ky i fundit foli për kundërshtarët dhe gjasat e Kosovës. "Me Danimarkën jemi ndeshur dy herë dhe njihemi mes vete (kemi dëshmuar se mund ta mposhtim), ndërsa me Zvicrën është hera e parë dhe shpresoj se mund t'ia dalim. Synimet tona janë të qarta. Të fitojmë dhe të kalojmë në fazën kualifikuese të EuroBasket 2025. Ky rrugëtim nuk do të jetë i lehtë, por as i pamundur", ka shtuar Rraci.
Kosova ndeshjen e parë do ta ketë në shtëpi ndaj Zvicrës, kurse më pas është mysafire e Danimarkës e Zvicrës, ndërsa kualifikimet i mbyll kundër danezëve në shtëpi.

# Ademi dhe ambasadori Abbott flasin për çështjen e licencimit të FFK-së



**Prishtinë, 26 prill** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, bashkë me sekretarin e përgjithshëm Taulant Hodaj, kanë pritur në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott. Ambasadori është interesuar për situatën në futbollin e Kosovës, me theks të veçantë për licencimin e FFK-së nga MKRS-ja, çështje të cilën e ka konsideruar si hap të rëndësishëm që Kosova të vazhdojë përparimin dhe konkurrencën në arenën ndërkombëtare. "Ambasadori Abbott ka thënë se Federata duhet të mbetet e pavarur nga politika dhe t'i plotësojë të gjitha kriteret për ta marrë licencën, derisa kryetari Ademi i ofroi mbështetjen e plotë në këtë drejtim. Në anën tjetër kryetari Ademi e falënderoi ambasadorin Abbott për vizitën dhe interesimin e tij në çështjet e FFK-së, po ashtu edhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm, derisa i ofroi gatishmërinë për të realizuar bashkë çdo projekt i cili ndihmon në masivizimin dhe zhvillimin e futbollit në Kosovë", thuhet në njoftimin e FFK-së.
Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë mbështet dhe është tifoz i Përfaqësueses së Kosovës, prandaj i pari i FFK-së i dhuroi fanellën e re në shenjë respekti.

## Quni: Ndeshja me Malin e Zi është e rëndësishme

**Prishtinë, 26 prill** - Pivoti Luigj Quni e vlerëson të rëndësishme ndeshjen me Malin e Zi. Quni është kthyer në Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll pasi ka munguar në dy ndeshjet me Bosnjë-Hercegovinën. Lojtari luftarak mungoi për shkak të një lëndimi të cilin e ka sanuar plotësisht. Kosova luan me Malin e Zi të enjten prej orës 20:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndeshja u takon kualifikimeve për "Euro 2024". "Në vitet e fundit jemi përmirësuar vazhdimisht. Këtë e tregon fakti që presioni për ndeshjet me kundërshtarë të caktuar është me të drejtë më i lartë. Kjo ndodh pasi pritshmëritë janë më të larta në vendin tonë", ka thënë Quni, që ka kompletuar një tjetër edicion të suksesshëm në Superligën e Zvicrës. Ai është pjesë e skuadrës Amicitia Zuerich. "Ndeshja në shtëpi kundër Malit të Zi është një moment i rëndësishëm për ne, për zhvillimin tonë të mëtejmë. Kjo përfshin përgatitjen taktike, mendore dhe fizike për kundërshtarin. Ne shpresojmë për mbështetjen e tifozëve në sallë", ka shtuar Quni.



## Ish-gruaja e Hakimit nuk heq dorë, i kërkon 10 milionë euro për divorcin



RABAT, 26 PRILL - Vijojnë lajmet e ndarjes së futbollistit maroken Achraf Hakimi me aktoren spanjolle-tuniziane Hiba Abouk. Sipas medieve, Hiba Abouk po kërkon 10 milionë euro për divorcin me yllin e PSG-së. Thuhet se ekipi ligjor i Abouk kërkon 10 milionë euro, ndërsa futbollisti ofrohet të paguajë vetëm dy milionë euro. Aktorja ka vendosur të ngrejë një padi kundër Hakimit për "mashtrim dhe keqadministrim të pasurive të tyre bashkëshortore". Ky vendim i saj vjen pasi ajo mori vesh se marokeni ia ka transferuar të gjitha pasuritë nënës së tij, Saida Mouh. Por nëna e futbollistit mohoi pretendimet, duke sugjeruar se ajo nuk ishte në dijeni të veprimeve të tilla. Abouk konfirmoi ndarjen e saj nga Hakimi më 27 mars mes lajmeve se futbollisti po përballej me hetim nga policia franceze si pjesë e një rasti të dyshuar përdhunimi. Por ekipi ligjor i Hakimit ka hedhur poshtë akuzat ndaj tij, duke sugjeruar se futbollisti ishte "viktimë e një tentative zhvatjeje".

# Denveri dhe Phoenixi në gjysmëfinale, Atlanta ndal marshimin e Bostonit



DENVER, 26 PRILL - Denveri ka prerë një biletë për në gjysmëfinalet "play-off" në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 112-109 ndaj Minnesotas, duke fituar 4-1 serinë e takimeve çerekfinale. Ndeshje e ekuilibruar deri në fund, ku për Denverin u dallua Jamal Murray me 35 pikë, mbështetur nga Nikola Jokiq me një "triple double" (28 pikë, 17 rebounde e 12 asistime). Përballë Denverit në gjysmëfinale do të jetë Phoenixit, që mposhti me rezultat 136-130 clippersat dhe fitoi po 4-1 serinë e takimeve mes tyre. Mungesa e Leonardos u ndje te clippersat (Powell 27 pikë), ndërsa për Sunsin shkëlqeu Bookeri me 47 pikë e 10 asistime si dhe Duranti, autor i 31 pikëve. Në Lindje ngecën skuadra e Bostonit, që u mund me rezultat 119-117 nga Atlanta, që mban hapur garën për një vend në gjysmëfinale. Trae Young me 38 pikë e 13 asistime ishte lider për Atlantan, duke i bërë të pavlefshme 35 pikët e Brownit për Bostonin që, pavarësisht humbjes, udhëheq 3-2 serinë e takimeve.

**"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE - KONFERENCA E LINDJES**

| | |
|---|---|
| Philadelphia - Brooklyn | (4-0) |
| Boston - Atlanta 117-119 | (3-2) |
| Cleveland - New York | (1-3) |
| Milwaukee - Miami | (1-3) |

**"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE - KONFERENCA E PERËNDIMIT**

| | |
|---|---|
| Sacramento - Golden State | (2-2) |
| Memphis - Lakers | (1-3) |
| Phoenix - Clippers | 136-130 (4-1) |
| Denver - Minnesota | 112-109 (4-1) |

# Dybala: Ronaldon e kam urryer gjithmonë, Mourinho trajner fantastik



PRISHTINË, 26 PRILL - Paulo Dybala është kthyer në një element vendimtar këtë sezon te Jose Mourinho këtë sezon. Në një intervistë për "DAZN" ish-sulmuesi i Juventusit foli për përvojat e tij. "Numri 10 i Romës do të jetë gjithmonë Francesco Totti, ashtu si Del Piero në Juventus. Bardhezinjtë më kërkuan drejtpërdrejt ta vishja numrin 10 dhe kjo ishte një kënaqësi e madhe. Mos i thuaj kurrë një propozimi të tillë. Ishin tri vjet të mira me Cristianon, ekipi ishte shumë i fortë dhe ai na dha diçka më shumë. Në Argjentinë rivaliteti në mes të Messit dhe Ronaldos ndihet thellë. Padyshim që si fëmijë kam qenë gjithmonë në anën e Messit", ka thënë Dybala. "Në një moment kur ishim pjesë e Juventusit, po fluturonim dhe Ronaldo erdhi tek unë për të folur për futboll. Ne folëm edhe për jetën tonë. Në një moment i thashë se e kam urryer si fëmijë dhe nisëm të qeshnim me njëri-tjetrin. Mes meje dhe Cristianos ka pasur gjithmonë një marrëdhënie të mirë. Mourinho ka një imazh dhe një fuqi të rëndësishme për gjithçka që përfaqëson në botën e futbollit. Para se të mbërrija në Romë, ai më telefonoi kur isha ende në Torino. Ndjeva diçka të veçantë me të. Është e vështirë në botën e futbollit të gjesh dikë që të thotë gjërat në mënyrë të sinqertë", ka shtuar Dybala.

## SHKURT

### Kumbulla ndaj Milanit e ka shansin e fundit për ta bindur Mourinhon

AS Roma do të përballet këtë fundjavë me Milanin në kampionat dhe një vend në Ligën e Kampionëve. Ky është objektivi i verdhekuqve. Por, problemet në mbrojtje janë kthyer në një shqetësim për Jose Mourinhon. Ndaj Milanit opsioni i fundit për trajnerin portugez është vetëm aktivizimi i Marsh Kumbullës si titullar. Ndeshjen e fundit nga minuta e parë, Kumbulla e ka më 12 mars ndaj Sasuolos, por një karton i kuq në atë ndeshje bëri që të mos i besoheshin më minuta përveç asaj ndaj Feynordit ku u aktivizua në të dytën. Mediet në Itali e shohin ndeshjen ndaj Milanit si shansin e fundit për mbrojtësin e kombëtares, për ta bindur Mourinhon për vlerat e tij.

### Pensionohet legjenda e atletikës, Mo Farah

Legjenda e sportit të atletikës, britaniku Mo Farah, ka vendosur t'i thotë "stop" karrierës në moshën 40-vjeçare, duke "varur atletet në gozhdë". Atleti i garave 5 dhe 10 mijë metrave, në të cilat ka fituar nga 3 tituj kampionë bote dhe 4 medalje të arta olimpike (Londër 2012 e Rio 2016), do të tërhiqet pas disa muajsh. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Mo Farah deklaroi se më 11 shtator do ta zhvillojë garën e tij të fundit, në Grat North Run. Në fakt, ai deklaroi se gara e fundit në Londër ishte e fundit për të, por ka kërkuar të zhvillojë edhe sfidë të fundit, për të dhënë një lamtumirë më të denjë. Për BBC ai shtoi: "Do të më mungojë ajo ndjesi që më jep konkurrimi. Gara e Great North Run do të jetë e fundit për mua dhe më pas do të them lamtumirë. Karriera ime ka qenë e jashtëzakonshme. Familja ime më ka mbështetur kudo në këtë udhëtim dhe tani do t'i dedikoj më shumë kohë. Gjithsesi, do të vazhdoj të jem i përfshirë në këtë sport".

### Ancelotti: Humbje e rëndë

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, e ka konsideruar të rëndë humbjen nga Girona (4-2) në La Liga. Trajneri italian ka vlerësuar se përcaktues në këtë ndeshje ishte mosfunksionimi si duhet në repartin e mbrojtjes. "Është e rëndë të humbasësh kështu. Në nivel difensiv ishte një sfidë e shëmtuar, kjo ishte përcaktuese. Ekipi nuk u fut fare në lojë. Ishte shumë poshtë në të gjithë senset. Reagimi i tifozëve? Është normale të jenë të mërzitur por, mos të harrojmë, jemi në finalen e Kupës së Mbretit dhe në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve", u shpreh Ancelotti.

### Messi i vendos kushte PSG-së për rinovimin e kontratës

Leo Messi dhe e ardhmja e tij mbeten një temë e hapur në Paris. Mediet sjellin shpesh versione të ndryshme, e radhës që e bën diçka të tillë është "Le Parisen". Sipas së përditshmes franceze, Leo është gati të firmosë një kontratë të re, por "pleshti" kërkon përmirësim të pagës. Kjo kërkesë e Messit bie ndesh me politikat e reja të klubit, i cili kërkon t'i limitojë shpenzimet, mbi të gjitha për lojtarët që janë në fund kontrate, apo ata që nuk shihen pjesë e projektit afatgjatë. Me këtë lëvizje, Messi largohet gjithnjë e më shumë nga Parisi.

## Unitedi ofron 90 milionë euro për Kanen

Manchester Unitedi është i gatshëm të bëjë sakrifica të mëdha për ta transferuar Harry Kanen. Sipas mediumit britanik "The Sun", gjiganti nga "Old Trafford" është i gatshëm t'i paguajë 90 milionë euro vetëm për ta bindur Tottenhamin. Gjithnjë sipas këtij mediumi, përfaqësuesi anglez do të merrte një rrogë të majme në "Teatrin e Ëndrrave". Më saktësisht, Kane do të paguhej 300 mijë funte në javë, respektivisht afro 17,5 milionë euro në vit. Kane e ka shprehur qe një kohë dëshirën për t'u larguar nga Tottenhami pasi është në kërkim të një klubi me të cilin do të mund të fitonte trofe.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023);lidhur me nenin 27.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr. 525 të datës 20.04.2023 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**
**për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. **Pozita:** **Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri**
   **Numri i referencës:** AJAFP/ZKA/06-04/23
   **Grada:** ZKA-A8
   **Numri i pozitave:** Katër (4)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksimi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri më formatin dhe kërkesat e përcaktuar nga metodologjia, që t'i mundësoj UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoi njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregon gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkohen nga UE dhe DD i/e tij.

**Kualifikimet themelore:**
- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërën nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

**Shkathtësitë e kërkuara**:
- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**
- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **12.05.2023 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) Br. 01/2023), vezano za Član 27.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 za kvalifikaciju radnih mesta, godišnjeg plana zapošljavanja za 2023. godinu, kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 525 datuma 20.04.2023 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje

**KONKURS**
**za popunjavanje slobodnih radnih mesta**

**1. Pozicija:** **Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti**

**Broj reference:** **AJAFP/ZKA/06-04/23**
**Koeficijent:** **ZKA-A8**
**Broj pozicija:** **Četiri (4)**
**Trajanje imenovanja:** **Na neodređeno vreme**

**Dužnosti i odgovornosti:**

• Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarnih informacija o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosijea i obavlja druge poslove vezanih za reviziju;
• Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranim pitanjima iu skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
• Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
• Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
• Pruža saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
• Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadatka za postizanje objektiva tima i departmana;
• Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
• Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
• Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
• Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

**Osnovne kvalifikacije:**
- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

**Potrebne veštine**:
- Poznavanje polja revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji važe za Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Veštine da predstavlja i štiti interese institucije i njenog integriteta ;
- Motivacione i komunikativne veštine u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

**Opšte informacije za kandidate:**
Naknada plate za objavljene pozicije vrši se u skladu sa zakonom na snazi.

**Procedura apliciranja:**
Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

**Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta**:
• službeni Formular NKR-a za apliciranje;
• kopiju lične karte Republike Kosova;
• dokaze o školskoj spremi (diploma fakulteta), Diplome stečene van Kosova moraju itd nostrifikovane;
• dokaze o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu sa priloženim dokazima iz Trusta)
• svedočenje iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci)
• dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.
Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije **12.05.2023** godine do **16.00** časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.
**Beleška:**
Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**03-111/01-82693/23**
**Datë: 26.04.2023**

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës:

## RISHPALLË KONKURS
## PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:**

1. Drejtor/e në IP "Dielli", Komuna e Prishtinës;
2. Drejtor/e në IP "Yllkat", Komuna e Prishtinës;
3. Drejtor/e në IP "Xixëllonjat", Komuna e Prishtinës;
4. Drejtor/e në IP "Buzëqeshja", Komuna e Prishtinës;
5. Drejtor/e në IP "Ardhmëria", Komuna e Prishtinës;
6. Drejtor/e në IP "Gëzimi Ynë", Komuna e Prishtinës;
7. Drejtor/e në IP "Fatosat", Komuna e Prishtinës;
8. Drejtor/e në IP "Lulevera", Komuna e Prishtinës.

**Institucioni:** **Komuna e Prishtinës**
**Drejtoria:** **Drejtoria për Arsim**
**Lloji i pozitës:** **Nëpunës i Shërbimit Publik**
**Titulli i mbikëqyrësit:** **Drejtoria e Arsimit**
**Kohëzgjatja e emërimit:** **Katër (4) vite;**

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

### 1. Informata të përgjithshme

1.1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 26.04.2023 deri më datën 11.05.2023;
1.2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
1.3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
1.4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
1.5. Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
1.6. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
1.7. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë te aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
1.9. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
1.10. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

***Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

### 2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

2.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 2.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 2.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 2.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 2.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
2.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve[1];
2.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimet të KSHLM;
2.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
 2.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
 2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
 2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor/eshë.
2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.[2]

### 3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

3.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
3.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
 3.2.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
3.3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
3.4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
3.5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët[3];
3.6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor[4];
3.7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike[5];
3.8. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës[6];

[1] Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.
[2] Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional
[3] Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapur kundër tyre.
